



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:020789

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05765014

P.nr.31/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Valon Hajdini, bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu, dhe procesmbajtësin praktikant H.K., duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit S.M. nga fshati..., Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.2 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.815/2019, të datës 11.02.2020. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në prezencën e palëve, Prokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Ajtene Zoni, të dëmtuarit I.V., të pandehurit S.M. si dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av.Arjan Prebreza, seanca ka qenë publike, e njëjta është regjistruar në procesverbal, Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor më 16.05.2024, ndërsa më dt.31.05.2024 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

S.M., nga i ati S., e ëma Sh., e vajzërisë V., i lindur me datë..., në fshatin..., Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, me numër personal..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike.

- Në bazë të nenit 362 par.1, pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) :

- R E F U Z O H E T A K U Z A -

Me datë 27.10.2018, në fshatin..., Komuna Skenderaj, pikërisht në vendin e quajtur “Aragja e Seferoviqe”, në cilësinë e personit përgjegjës në kuader të personit juridik “KEDS”, nuk i ndërmer veprimet e nevojshme të inspektimit dhe sigurimit të rrjetit elektrik, për të cilat ka përgjegjësi ligjore, ashtu si rrjedhojë e këtij mosveprimi dhe pakujdesisë shkakton rrezik për jetën e njerëzve, ashtu që në kohën dhe vendin e lartcekur si pasojë e këputjes së përçuesit ajror “faze RRTU”, ku në atë vend djali i të dëmtuarit I.V. ka qenë duke e kullotur lopën të cilën arë e mbanë me qira, që si pasojë lopa është prekur me telin e këputur dhe ka ardhur deri të ngordhja e saj, ku të dëmtuarit i shkakton dëm në shumë prej 1600 euro.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.2 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).
- Shpenzimet e procedurës penale mbeshin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- Lidhur me kërkesën pasurore juridike pala e dëmtuar I.V. udhëzohet në kontest juridiko civil

- A r s y e t i m -

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.815/19, të datës 11.02.2020 pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega Skenderaj- Departamenti i përgjithshëm, ndaj të pandehurit S.M., për shkak të veprës penale : Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.2 dhe 1 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës penale:

Gjykata në këtë çështje penale më datë 16.05.2024 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, e cila ka qenë e hapur për publikun, ndërsa ishin prezent prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i dëmtuari I.V., i pandehuri S.M. si dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av.Arjan Prebreza, ashtu që i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë 16.05.2024 pas leximit të aktakuzës deklaroi se, heq dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit S.M. në drejtim të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par. 2 dhe 1 të KPRK-së, me arsyetim se në veprimet e të pandehurit nuk përmbushen elementet e veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, kjo bazuar edhe nga ekspertiza elektro – energjetike, në bazë të se cilës eksperti ka konstatuar se vendi ku ka ndodhur rasti është zonë e përgjegjësisë e Kompanisë KEDS, përgjegjës i këtij rasti është Kompania KEDS, e jo i pandehuri S.M., ndërsa

sa i përket dëmit të shkaktuar ashtu siç u njoftuar sot nga ana e të dëmtuarit, tani është duke u zhvilluar një procedurë civile dhe ka konsideruar se ndaj të njëjtit duhet të heqim dorë pasi që nuk ka përgjegjësi penale.

Meqenëse prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor mbajtur më datë 16.05.2024 është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurit S.M. nga fshati..., Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.2 dhe 1 të KPRK-së, gjykata konform nenit 362 par.1, pika 1.1 të KPP-së, ka marrë aktgjykim me të cilin e ka refuzuar akuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.815/2019, të datës 11.02.2020.

- Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPP-së.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata të dëmtuarin Ismet Vjovoda e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil duke u mbështetur në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPPK-së,

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 362 par.1, pika 1.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.31/2020 me datë 31.05.2024.

Procesmbajtësi

H.K.

Gjyqtari i vetëm gjykues

Valon Hajdini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.